

STATUT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“TAILOR’S VISION” SHPK

I. PJESEMARRJA

Neni 1
Ortakët

- 1.1 Ortakët e shoqërisë “Tailor’s Vision” SHPK (“Shoqëria”) janë si më poshtë:
- **Znj. Adelina Krasniqi**, shtetase britanike, lindur më 10.06.1983, në Prizren, mbajtëse e pasaportës me nr. 523757002; dhe
 - **Z. Drialb Koxhaj**, shtetas shqiptar, lindur më 19.05.1999, në Berat, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal: J90519052S.
- 1.2 Përgjegjësia e ortakëve është e kufizuar në përpjesëtim me kontributin e tyre në kapitalin e Shoqërisë, i cili përfaqësohet në kuota.
- 1.3 Në këtë Statut:

“**Bllokim**” është situata kur një vendim i asamblesë së përgjithshme (por edhe i Administratorëve sipas rastit) nuk mund të merret për shkak të mosmarrëveshjes midis tyre, ose për shkak se kuorumi ose shumica e kërkuar në asamble për marrjen e vendimit nuk mund të arrihet dhe si pasojë e kësaj aktiviteti i Shoqërisë ose një pjesë e rëndësishme e tij pengohet ose bllokohet.

“**Ditë Pune**” është një ditë përveç të shtunës, të dielës ose ditëve të festave zyrtare kur bankat në Shqipëri janë të hapura për transaksionet normale të biznesit.

“**Qendra Kombëtare e Biznesit**” është *Qendra Kombëtare e Biznesit*, një institucion publik ku mbahet regjistri tregtar.

“**Ortak**” është Znj. Adelina Krasniqi ose Z. Drialb Koxhaj ose çdo ortak tjetër i Shoqërisë kohë pas kohe.

“**Person i lidhur**” do të thotë, në lidhje me çdo person (“**Personi Përkatës**”);

- a) bashkëshorti ose partneri i Personit Përkatës;
- b) çdo person tjetër (qoftë i gjinisë së ndryshme ose i të njëjtës gjinie) me të cilin Personi Përkatës jeton si partner në një marrëdhënie të qëndrueshme familjare;
- c) fëmijët biologjikë ose fëmijët e bashkëshortit/es të Personit Përkatës;
- d) çdo fëmijë biologjik ose fëmijët e bashkëshortit/es të një personi referuar në paragrafin (b) (dhe që nuk janë fëmijët biologjikë ose fëmijët e bashkëshortit/es të

 D. K

Personit Përkatës) të cilët jetojnë me Personin Përkatës dhe që nuk e kanë mbushur moshën 18;

- e) prindërit, vëllezërit ose motrat e Personit Përkatës;
- f) çdo person juridik:
 - i. ku Personi Përkatës dhe/ose një person sipas paragrafëve nga (a) në (e) zotëron kuota ose aksione në kapitalin e atij personi juridik të një vlere nominale të barabartë me të paktën njëzetë përqind (20%) të atij kapitali; ose
 - ii. në lidhje me të cilën Personi Përkatës dhe/ose një person sipas paragrafëve nga (a) në (e) ka të drejtë të ushtrojë ose kontrollojë ushtrimin e më shumë se njëzetë përqind (20%) të kompetencës për të votuar në ndonjë asamble të përgjithshme të atij personi juridik;

“**Ligji i Zbatueshëm**” është çdo ligj, statut, legjislacioni i lidhur, traktat, rregullore, direktivë, vendim, akt nënligjor, rregullore, kod, urdhër, dekret, masë ose vendim i ndonjë autoriteti qeveritar, organ ligjor, administrativ ose rregullator, gjykatë ose agjenci, në secilin rast, në masën që është ligjërish i detyrueshëm për personin përkatës.

“**Ligji për Shoqëritë Tregtare**” është ligji nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar kohë pas kohe.

“**Statut**” është ky statuti i nënshkruar nga Ortakët dhe i miratuar nga asambleja e përgjithshme.

II. EMRI, SELIA, FORMA LIGJORE, KAPITALI

Neni 2

Emri

- 2.1 Emri i plotë i shoqërisë në dokumentacionin zyrtar është “**Tailor’s Vision**” SHPK.
- 2.2 Në të gjithë dokumentet, faturat, reklamat dhe botimet e lëshuara nga Shoqëria, pavarësisht mjetit të transmetimit, emri i Shoqërisë duhet të paraprihet ose ndiqet nga:
 - i. fjalët “*Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar*” ose “*SHPK*”;
 - ii. numri i saj unik i identifikimit (NUIS);
 - iii. kapitali themeltar dhe kapitali i paguar i Shoqërisë
 - iv. adresa e selisë; dhe
 - v. një shënim që Shoqëria është në likuidim, nëse zbatohet.

Neni 3

Forma ligjore

- 3.1 Shoqëria është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar (“**Ligji për Shoqëritë Tregtare**”).
- 3.2 Shoqëria mund të transformohet në një formë tjetër ligjore në përputhje me legjislacionin shqiptar.



Neni 4
Baza ligjore

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj në përputhje me Statutin, Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe dispozitat e tjera të legjislacionit shqiptar.

Neni 5
Kohëzgjatja

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një afat të pacaktuar.

Neni 6
Selia dhe Degët

- 6.1 Selia e Shoqërisë është në **Rruga Demir Progri, Pallati 1, Apartamenti 9, 1001, Tiranë, Shqipëri**
- 6.2 Secili nga Administratorët e Shoqërisë mund të hapë adresa dytësore për Shoqërinë në Shqipëri, në përputhje me nevojat e Shoqërisë dhe me rregullat e përcaktuara në këtë statut.
- 6.3 Asambleja e përgjithshme mund të hapë ose mbyllë agjenci, zyra përfaqësimi, degë që nuk kanë natyrën e adresave dytësore, si dhe të vendosë për zhvendosjen e selisë.

Neni 7
Objekti

- 7.1 Shoqëria do të ushtrojë çdo aktivitet në fushat e mëposhtme:
- Prodhim dhe distribucion veshjesh në Shqipëri dhe jashtë saj;
 - Import-eksport;
 - Tregti me shumicë dhe pakicë të artikujve të ndryshëm, aksesore tekstili, makinerish prodhimi tekstili dhe të mallrave që prodhon dhe tregton;
 - Lavanteri;
 - Stampime dhe qëndisje, printime dixhitale, sublim dhe shtyp;
 - Studio grafike në fushën e rrobaqepësisë;
 - Kryerja e operacioneve ekonomike dhe juridike, industriale, prodhuese tregtare, të cilat lidhen drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë së Shoqërisë brenda kuadrit ligjor;
 - Prodhim, tregtim veshjesh: promocionale, sportive, korporatash, pune;
 - Tregtim, prodhim: aksesore sportive, aksesore lëkure, flamujsh, baneta, reklama;
 - Në fushën e konfeksioneve, larje, ngjyrosje, hekurosje dhe paketim;
 - Dhenie me qira e veshjeve ceremoniale dhe uniformave;
 - Me vendim të ortakëve të Shoqërisë mund të marrë pjesë në veprimtari bashkëpunimi me shoqëri të tjera vendase apo të huaja për realizimin e projekteve të fushave të ndryshme të biznesit.



- 7.2 Për të arritur qëllimin e lartpërmendur, Shoqëria ka të drejtë:
- Të lidhë të gjitha llojet e kontratave ose marrëveshjeve me personat fizikë ose me personat juridikë publikë dhe privatë, shoqëritë, shtetin dhe subjektet e huaja ose shqiptare;
 - Të themelojë të gjitha llojet e shoqërive ose të marrë pjesë në shoqëritë shqiptare ose të huaja, sipërmarrje të përbashkëta ose lloje të ndryshme biznesesh, që kanë objekte të njëjta ose të ngjashme;
 - Të hapë degë ose agjenci në Shqipëri ose jashtë saj;
 - Të përfaqësojë bizneset shqiptare ose të huaja që lidhen me objektin e Shoqërisë;
 - Të lidhë marrëveshje kredie, të pranojë garanci personale ose të tjera, të marrë përsipër detyrime, të emetojë drafte, kambiale, çeqe ose letra të tjera me vlerë të kolateralit; dhe
 - Të ndër marrë ndonjë aktivitet tregtar ose aktivitet tjetër dhe të kryejë çdo veprim ligjor ose transaksion që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e Shoqërisë, ose që synon drejtpërsëdrejti ose tërthorazi përbushjen e objektit të Shoqërisë.
- 7.3 Shoqëria mund të kryejë në mënyrë dytësore dhe në çdo rast me qëllim arritjen e objektivave të Shoqërisë, çdo veprim tregtar, industrial, financiar dhe transaksion në lidhje me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme të cilat janë të nevojshme ose të përshtatshme për arritjen e objektivave të Shoqërisë.
- 7.4 Shoqëria mund të kryejë të gjitha veprimtaritë ndihmëse, si dhe të gjitha aktivitetet e nevojshme ose të përshtatshme për të arritur qëllimin e biznesit të Shoqërisë në përputhje me ligjin.
- 7.5 Objekti i Shoqërisë mund të modifikohet ose ndryshohet me vendim të asamblesë së përgjithshme.

Neni 8 Kapitali

- 8.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 125,000 Lekë (njëqind e njëzet e pesë mijë *lekë*) dhe përbëhet në këtë datë nga 2 (*dy*) kuota. Secili nga Ortakët zotëron 1 (një) kuota me një vlerë nominale që është në përpjesëtim me kontributin e secilit Ortak në kapitalin e Shoqërisë. Transferimi i mëvonshëm i kuotës së Ortakëve në favor të Ortakut tjetër ose të ndonjë pale të tretë nuk do të konsiderohet ndryshim i këtij Statuti.
- 8.2 Kapitali mund të paguhet në një ose më shumë këste brenda 1 (një) viti nga regjistrimi i Shoqërisë
- 8.3 Në momentin e miratimit të këtij Statuti, kuotat ndahen mes Ortakëve si më poshtë:

Ortakët	# i kuotave	Përqindja
Adelina Krasniqi	1	50%
Drialb Koxhaj	1	50%

Neni 9

Transferimi i pjesëve të kapitalit. Kufizimet mbi transferimin. Opsioni për shitjen.




9.1 Përveç parashikimeve në nenin 9.2 më poshtë, kur është i zbatueshëm, Ortakët e Shoqërisë nuk mund të shesin, transferojnë, cedojnë, dhurojnë, vendosin peng, transferojnë pronësinë e zhveshur ose uzufuktin, barrësojnë ndonjë pjesë ose tërësinë e kuotave të tyre në Shoqëri ose bien dakord për ndonjë nga këto akte pa vendimin paraprak me shkrim të asamblesë së përgjithshme me të paktën $\frac{3}{4}$ e votave. Sa më sipër nuk do të zbatohet për veprimet e kryera me ose në favor të Personave të Lidhur të secilit ortak.

9.2 Kuotat mund të transferohen lirisht vetëm midis Ortakëve. Kuotat e kapitalit themeltar mund të shiten tek palët e treta që nuk janë ortakët e Shoqërisë duke përmbushur kushtet e neneve 9.3 - 9.11 më poshtë.

Procedura e ushtrimit të të drejtës së parablerjes

9.3 Ortaku, i cili ka për qëllim të shesë tërësisht ose pjesërisht kuotën e tij ("Ortaku Shitës"), do të njoftojë menjëherë Ortakun/Ortakët tjetër ("Ortakët Jo-shitës") dhe Administratorin/ët e Shoqërisë, në përputhje me nenin 14.4 më poshtë, për të gjitha kushtet dhe afatet e transferimit të ardhshëm të kuotave ("Njoftimi për Shitje"), duke përfshirë por jo duke u kufizuar në:

- (i) emrin e përfituesit,
- (ii) çmimin që do të paguhet për transferimin e kuotave, duke përcaktuar nëse çmimi është në para ose në natyrë,
- (iii) një konfirmim me shkrim të përfituesit të ardhshëm që oferta që i është bërë Ortakut Shitës është në mirëbesim dhe që ai/ajo ka ose do të ketë në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes së shitblerjes së kuotave, mjetet financiare ose mjetet e tjera të së njëjtës natyrë për të paguar çmimin që i është ofruar Ortakut Shitës dhe do t'ia bëjë rregullisht këtë pagesë Ortakut Shitës, dhe
- (iv) konfirmimin e përfituesit të ardhshëm që ai do të jetë i detyruar sipas kushteve të Statutit dhe çdo marrëveshje të Ortakëve, nëse ka, që ekziston dhe është në fuqi midis Ortakëve.

9.4 Ortaku/ët Jo-shitës mund të ushtrojë të drejtën e tij të parablerjes me anë të një njoftimi me shkrim ("Njoftim për Blerje") që i dërgohet në përputhje me Nenin 14.4 më poshtë Ortakut Shitës dhe Administratorit/ëve të Shoqërisë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data e marrjes së Njoftimit për Shitje.

9.5 E drejta e parablerjes duhet të ushtrohet mbi të gjitha kuotat e përcaktuara në Njoftimin për Shitje dhe nuk lejohet ushtrimi i pjesshëm i saj.

9.6 Njoftimi për Blerje duhet të shprehë qartësisht vullnetin e Ortakut Jo-Shitës për të ushtruar të drejtën e tij të parablerjes mbi të gjitha kuotat e përcaktuara në Njoftimin për Shitje dhe me të njëjtin çmim, duke përfshirë të njëjtat kushte dhe afate, të përcaktuar në Njoftimin për Shitje. Në rast se më shumë se një Ortak Jo-Shitës ushtron të drejtën e parablerjes, secili prej tyre ka të drejtë të blejë një përqindje të kuotave në përpjesëtim me kuotat e zotëruara nga Ortakët Jo-Shitës, të cilët kanë ushtruar në mënyrë të vlefshme të drejtën e para blerjes.

9.7 Në rast se e drejta e parablerjes nuk është ushtruar, Ortaku(ët) Shitës mund të transferojë kuotat të ndonjë palë e tretë por vetëm nëse transferimi kryhet sipas të njëjtave kushte dhe afate të treguara në Njoftimin për Shitje.




D. K

- 9.8 Ortaku Shitës do t'i japë Ortakut(ve) Jo-Shitës një kopje të marrëveshjes së shitjes së kuotave të lidhur me palën e tretë. Asambleja e përgjithshme do të miratojë me shkrim përfundimin e procedurës dhe plotësimin e kushteve të përcaktuara në të dhe formalisht do të miratojë transferimin e kuotave tek pala e tretë, sa më shpejt të jetë e mundur, por në çdo rast, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e njoftimit të marrëveshjes së nënshkruar për shitjen e kuotave midis Ortakut Shitës dhe palës së tretë.
- 9.9 Në rast se kuotat e ofruara për shitje nuk janë shitur brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga e nesërmja e ditës kur Ortaku Shitës është i lirë t'ia shesë kuotat një pale të tretë, atëherë e drejta e parablerjes e Ortakut(ve) Jo-Shitës do të rilindë në lidhje me kuotat e ofruara në të njëjtën mënyrë dhe do të rindiqet e njëjta procedurë si më sipër.
- 9.10 Pavarësisht nenit 9.3 më sipër, Ortaku Shitës mund t'i ofrojë kuotat për shitje Ortakut/ëve Jo-Shitës edhe në rast se ato nuk i janë propozuar paraprakisht një pale të tretë, duke përcaktuar çmimin, kushtet e pagesës së tij, afatet dhe kushtet e tjera të rëndësishme të shitjes dhe Ortakët do të ndjekin, për aq sa është e zbatueshme, të njëjtën procedurë të përcaktuar më sipër.
- 9.11 Çdo transferim kuotash që nuk është në përputhje me dispozitat e këtij neni konsiderohet i pavlefshëm. Megjithatë, Ortakët nuk mund të refuzojnë dhënien e pëlqimit të tyre në asamblenë e përgjithshme në rast se procedura e mësipërme është respektuar. Në të kundërt ata janë përgjegjës ndaj Ortakut Shitës dhe detyrohen të dëmshpërblejnë humbjen e çmimit të shitjes si dhe çdo dëm tjetër të pësuar nga ky i fundit si pasojë e vonesës ose të refuzimit për transferimin e kuotës.

Opsioni i shitjes

- 9.12 Në rast Bllokimi, sipas përkufizimit të këtij Statuti, që zgjat më shumë se 30 (tridhjetë) ditë, Ortaku Znj. Krasniqi ka të drejtë (opsionin) t'i kërkojë Ortakut tjetër, Z. Koxhaj (apo ndonjë Ortaku tjetër që mund të ketë blerë kuotën e Z. Koxhaj në Shoqëri) që të blejë kuotën e saj në Shoqëri.
- 9.13 Ortaku, Znj. Krasniqi do t'i njoftojë Ortakut tjetër, Z. Koxhaj kërkesën për blerjen e kuotës së saj në Shoqëri me anë të një njoftimi të dërguar sipas Nenit 14.4 më poshtë, dhe Ortaku tjetër është i detyruar të vijojë me blerjen sipas nenit të mëposhtëm.
- 9.14 Çmimi për blerjen e kuotës në këtë rast, do të vendoset me marrëveshje ndërmjet Ortakëve. Në rast mosmarrëveshje ndërmjet Ortakëve lidhur me çmimin e blerjes së kuotës, çmimi do të vendoset nga një vlerësues i pavarur, i zgjedhur nga të dy Ortakët dhe kostoja për të cilin do të ndahet në mënyrë të barabartë ndërmjet Palëve. Në rast mosmarrëveshje ndërmjet Ortakëve për zgjedhjen e vlerësuesit të pavarur, vlerësuesi i pavarur mund të zgjidhet nga Znj. Krasniqi ndërmjet audituesve ligjorë të pavarur të njërit prej Big Four (Price Waterhouse Coopers, EY, Deloitte&Touche Tohmatsu, and KPMG). Pagesa e çmimit duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga momenti i përcaktimit të vlerës së kuotës prej audituesit ligjor në rast të kundërt Ortaku tjetër detyrohet të paguajë një penalitet 100 Euro në ditë.

Neni 10 Zmadhimi kapitalit

- 10.1 Ortakët mund të zmadhojnë kontributin e tyre në kapitalin e Shoqërisë. Zmadhimi i kapitalit të Shoqërisë mund të kryhet me zmadhimin e vlerës nominale të kuotave ekzistuese ose me çdo mënyrë tjetër të përcaktuar nga ligji. Kontributet e Ortakëve mund të jenë në para apo në çfarëdo formë të lejuar nga ligji, duke përfshirë edhe kontributet në natyrë.
- 10.2 Ortakët mund të financojnë Shoqërinë nëpërmjet huave me ose pa interes, apo në çdo formë tjetër të lejuar nga ligji që është e ndryshme nga zmadhimi i kapitalit, rast në të cilin është i nevojshëm miratimi paraprak i asamblesë së përgjithshme.
- 10.3 Mënyra e zmadhimit të kapitalit, natyra e kontributeve dhe kushtet e pagimit të kontributeve nga Ortakët, do të vendosen rast pas rasti me vendim të asamblesë së përgjithshme. Vendimet e asamblesë së përgjithshme në këtë rast mund të përfshijnë ndër të tjera gjobat dhe/ose pasojat për një ortak në rast të mos-pagesës së kontributit në afatin e rënë dakord duke përfshirë, por pa u kufizuar në (i) zvogëlimin e pjesës së ortakut në kapital, (ii) interesin për pagesat e vonuara, etj.
- 10.4 Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet gjithashtu nëpërmjet nënshkrimit dhe pagesës së kuotave të reja të kapitalit nga ortakët e rinj, par miratimit paraprak me shkrim nga asambleja e përgjithshme.

Neni 11 **Zvogëlimi kapitalit**

Bazuar në vendimin e asamblesë së përgjithshme, zvogëlimi i kapitalit do të kryhet në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

III. STRUKTURA DREJTUESE

Neni 12 **Asambleja e Përgjithshme**

- 12.1 Vendimet kryesore të veprimtarisë së Shoqërisë merren nga asambleja e përgjithshme, e cila është organi më i lartë i Shoqërisë që ka të drejtë të marrë vendime për të gjitha çështjet e aktivitetit të saj.
- 12.2 Çdo kuotë garanton të drejtën e një vote në përpjesëtim me vlerën e saj nominale në asamblesë të përgjithshme të ortakëve, të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në organet drejtuese, të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimeve të Shoqërisë si dhe të drejta të tjera të parashikuara sipas këtij Statuti, marrëveshjet midis Ortakëve, nëse ka, dhe dispozitat ligjore të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
- 12.3 Çdo transferim ose krijim garancie mbi kuotat do të bëhet në përputhje me nenin 9 dhe/ose me miratimin paraprak të asamblesë së përgjithshme siç parashikohet në të.
- 12.4 Asambleja e përgjithshme do të ketë të drejtë të vendosë për çështjet e mëposhtme:



- a. modifikimin dhe ndryshimin e këtij Statuti;
- b. pranimin e ortakëve të rinj, kur zbatohet (pas zmadhimit të kapitalit apo transferimit të kuotave);
- c. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit themeltar;
- d. vendosjen për shkrirjen, prishjen, likuidim dhe çdo lloj transformimi tjetër të Shoqërisë;
- e. miratimin e blerjes edhe/ose shitjes së interesave pjesëmarrëse në shoqëritë brenda apo jashtë Shqipërisë;
- f. lëshimin e garancive dhe kolateraleve, miratimeve dhe garancive për borxhet e palëve të treta;
- g. themelimin dhe/ose mbylljen e degëve dhe përfaqësive jashtë territorit të Shqipërisë;
- h. miratimin e raporteve vjetore dhe bilanceve dhe miratimin e shpërndarjes së fitimit;
- i. miratimin e rregullave të brendshme të administrimit;
- j. depozitim të padive kundër anëtarëve të organeve të Shoqërisë;
- k. miratimin e blerjes, shitjes dhe vendosjen e hipotekës mbi pasuritë e paluajshme të Shoqërisë;
- l. çdo transaksion midis Shoqërisë dhe çdo personi tjetër që përfaqëson Shoqërinë ose me Personat e Lidhur në lidhje me atë person;
- m. prishjen e Shoqërisë;
- n. emërimin dhe revokimin e administratorit(ëve);
- o. miratimin e pagës së administratorit;
- p. miratimin e ekspertëve kontabël të autorizuar dhe shpërblimit të tyre;
- q. organizimin e strukturës së Shoqërisë;
- r. përcaktimin e buxhetit vjetor;
- s. miratimin e çdo çështje tjetër që i takon për zgjidhje asamblesë së përgjithshme, me ligj dhe/ose sipas këtij Statuti.

Neni 13

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme

- 13.1 Asambleja e përgjithshme nuk do të mbajë asnjë diskutim nëse nuk ka kuorum në fillim të mbledhjes. Kuorumi për asamblenë e përgjithshme është prania, brenda gjysmë ore nga koha e përcaktuar për fillimin e saj, personalisht ose me anë të përfaqësuesit me prokurë, të cilët zotërojnë më shumë se (i) tridhjetë për qind të numrit total të votave në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë shumicë të thjeshtë ose (ii) gjysmën e numrit total të votave në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë shumicë të cilësuar.

Nëse, pas gjysmë ore nga koha e përcaktuar për fillimin e asamblesë, nuk ka kuorum, asambleja do të shtyhet pas një jave në të njëjtën ditë, në të njëjtën orë dhe në të njëjtin vend ose në një datë të mëvonshme nëse kjo gjë specifikohet në njoftimin e thirrjes së asamblesë së përgjithshme, përveç rasteve kur Ortakët bien dakord ndryshe.

- 13.2 Vendimet në lidhje me ndryshimin e këtij Statuti, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, shpërndarjen e fitimit, riorganizimin dhe shpërbërjen e Shoqërisë kërkojnë një shumicë të cilësuar prej të paktën 3/4 të votave të Ortakëve të pranishëm në asamble ("Shumicë e Cilësuar"). Të gjitha vendimet e tjera të asamblesë së përgjithshme, sipas dispozitave të tjera në këtë Statut, mund të miratohen me shumicë të thjeshtë të Ortakëve të pranishëm apo të përfaqësuar në asamble ("Shumica e Thjeshtë").



Dok

Shumica e Thjeshtë ose Shumica e Cilësuar, sipas rastit, do të përcaktohet në përputhje me të drejtat për të votuar të Ortakëve pjesëmarrës në asamble; me kusht që abstenimi nuk do të llogaritet.

- 13.3 Kur asambleja e përgjithshme nuk thirret siç përcaktohet në nenin 14 të këtij Statuti, ajo mund të marrë vendime vetëm nëse të gjithë Ortakët e Shoqërisë janë të pranishëm në asamble dhe bien dakord të vazhdojnë, pavarësisht parregullsisë.
- 13.4 Ortakët njohin dhe bien dakord për të marrë vendime të shkruara për Shoqërinë. Vendimet e propozuara së bashku me dokumentacionin që mbështet vendimet duhet t'u dërgohen Ortakëve në përputhje me nenin 14.4. Ortakët do të vendosin për vendimet e propozuara brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga data e njoftimit të dokumentit që përmban tekstin e vendimeve, duke i kthyer Ortakut tjetër dhe duke njoftuar Administratorin e Shoqërisë brenda kësaj periudhe një kopje origjinale të nënshkruar të dokumentit ose me e-mail një kopje të skanuar të dokumentit të nënshkruar. Për këtë qëllim, të gjithë Ortakët mund të nënshkruajnë kopje të veçanta, por të njëjta të dokumentit që përmban tekstin e vendimeve të propozuara.
- 13.5 Ortakët mund të miratojnë një vendim me shkrim në mungesë të formaliteteve të parashikuara në nenin 13.4 me kusht që të gjithë Ortakët të bien dakord për miratimin e një vendimi të tillë. Për këtë qëllim, të gjithë ortakët mund të nënshkruajnë vendime të veçanta, por të njëjta, ku një kopje origjinale e nënshkruar duhet t'i dërgohet e të ruhet në Shoqëri.
- 13.6 Ortakët angazhohen të sillen me mirëbesim dhe të shmangin sa më shumë të jetë e mundshme rastet e Bllokimit. Nëse një rast Bllokimi verifikohet, Ortakët, në kuadër të vijimit të funksionimit normal të Shoqërisë detyrohen dhe janë përgjegjës personalisht kundrejt njëri tjetrit dhe/ose Shoqërisë për të kryer ose për të mos kryer veprimet minimale në mënyrë që Shoqëria të ruajë *status quo*-në, përveç rastit kur ruajtja e *status quo*-së sjell një dëm të drejtpërdrejtë ose detyrim qartësisht të verifikueshëm në dëm të Shoqërisë.

Neni 14

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

- 14.1 Asambleja e përgjithshme mund të thirret nga secili prej Administratorëve të Shoqërisë të paktën një herë në vit në selinë e Shoqërisë ose në çdo vend tjetër siç përcaktohet në njoftim.
- 14.2 Ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të votave të përgjithshme të Shoqërisë mund t'i kërkojnë Administratorit me shkrim, përfshirë postën elektronike për thirrjen e asamblesë së përgjithshme. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet dhe objektivat dhe çështjet për të cilat asambleja e ortakëve duhet të vendosë. Administratori është i detyruar të thërrasë asamblenë e përgjithshme në përputhje me nenin 84 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare (përfshirë me anë të postës elektronike), përndryshe Ortakët që kanë kërkuar mbledhjen kanë të drejtë ta thërrasin vetë asamblenë e përgjithshme sipas kërkesave të njoftimit të parashikuara në nenin 14.3 më poshtë.
- 14.3 Asambleja e përgjithshme do të thirret me njoftim me shkrim të lëshuar nga Administratori, i cili duhet t'u dërgohet Ortakëve apo përfaqësuesve të Ortakëve me postë të shpejtë me lajmërim marrje dhe postë elektronike (email) jo më vonë se 7 (shatë) ditë përpara ditës së caktuar për mbledhjen. Njoftimi



për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme duhet të përcaktojë datën, orën dhe vendin e mbledhjes si dhe çështjet që do të diskutohen (rendi i ditës) dhe, në rast të një asambleje vjetore për miratimin e pasqyrave financiare, duhet të përfshijë pasqyrat e plota financiare dhe raportet e auditimit nëse ka. Në çdo rast, njoftimi dorazi nëpërmjet nënshkrimit të Ortakut(ëve) do të jetë i mjaftueshëm për efekt të thirrjes së mbledhjes së asamblesë.

14.4 Ortakët janë personalisht përgjegjës që t'i njoftojnë Administratorit të Shoqërisë të gjitha të dhënat e tyre të kontaktit duke përfshirë, por pa u kufizuar në adresën e tyre postare, adresën e postës elektronike, dhe gjithashtu të njoftojnë Administratorin për çdo ndryshim pasues të të dhënave të tyre të kontaktit.

14.4.1. Përveç kur parashikohet ndryshe, një njoftim që i jepet një pale sipas ose në lidhje me këtë Statut:

- i. do të jetë me shkrim dhe në gjuhën shqipe;
- ii. do të nënshkruhet nga ose në emër të palës që e ka lëshuar atë;
- iii. do t'i dërgohet palës përkatëse në adresën e specifikuar në nenin 14.4.2, ose në një adresë tjetër, siç ajo palë mund të njoftojë palën tjetër në përputhje me dispozitat e këtij neni 14; dhe
- iv. do të:
 - dërgohet dorazi; ose
 - dërgohet me postë të regjistruar me lajmërim marrje ose postë të shpejtë;
 - dërgohet me postë elektronike me konfirmim marrje; dhe
- v. konsiderohet i marrë siç përcaktohet në nenin 14.4.4.

14.4.2. Adresat për shërbimin e njoftimeve janë si më poshtë:

- i. Adelina Krasniqi
adresa: Rruga Ibrahim Kodra, Nd. 4/9, 1001, Tiranë, Shqipëri
e-mail: ggapliss@gmail.com
- ii. Drialb Koxhaj
adresa: Rruga Demir Progri, Ndertesë 1, ap 9, njësi administrative nr. 9, Tirana
e-mail: []

14.4.3. Një Ortak mund të ndryshojë të dhënat e tij në lidhje me dhënien e njoftimeve siç është përcaktuar në nenin 14.4.2 duke njoftuar Ortakun tjetër dhe Shoqërinë. Çdo ndryshim që njoftohet në përputhje me nenin 14.4.3 do të jetë i zbatueshëm prej orës 9:00 deri në:

- i. datën (nëse ka) e përcaktuar në njoftim si data e hyrjes në fuqi të ndryshimit; ose
- ii. pesë ditë pune pas marrjes së njoftimit.

14.4.4. Njoftimi do të konsiderohet i kryer:

- i. nëse dërgohet dorazi, duke nënshkruar njoftimin e thirrjes dhe/ose dokument tjetër për këtë qëllim; ose
- ii. nëse dërgohet nëpërmjet postës së regjistruar me lajmërim marrje ose poste të shpejtë, nëpërmjet nënshkrimit të konfirmimit të marrjes ose në kohën që njoftimi është lënë në adresë ose në orën 16:00 të ditës në të cilën postieri nuk ka mundur të dorëzojë njoftimin dhe ka shënuar që Ortaku është larguar, adresa nuk ekziston etj.; dhe



DoK

- iii. nëse dërgohet me e-mail, në kohën e dërgimit me kusht që e-mail-i është dërguar me konfirmim marrje dhe ky konfirmim marrje është marrë nga pala dërguese, ose nëse pala marrëse konfirmon me email marrjen dijani.

Në përputhje me nenin 14.3 më sipër, përveç rastit kur njoftimi kryhet sipas pikës i., mënyrat për kryerjen e njoftimit sipas pikave ii. dhe iii. janë kumulative dhe duhen ndjekur paralelisht. Për të shmangur çdo dyshim, njoftimi konsiderohet i plotë në ditën në të cilën kryhet veprimi i fundit sipas pikave ii. dhe iii.

- 14.5 Secili nga Ortakët ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër në përputhje me nenin 85 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Neni 15 **Zhvillimi i Mbledhjes**

- 15.1 Asambleja e përgjithshme do të kryesohet nga kryetari i saj që emërohet nga Ortakët e pranishëm në mbledhje me Shumicë të Thjeshtë, ose nga Ortaku që ka thirrur mbledhjen ose që ka emëruar Administratorin që ka thirrur mbledhjen në rast se Ortakët nuk bien dakord. Mbledhja mund të zhvillohet gjithashtu përmes mjeteve të komunikimit në distancë (psh. skype, viber, whatsapp, zoom, microsoft teams etj.), përfshirë konferencën telefonike, me kusht që të gjithë Ortakët pjesëmarrës të mund të dëgjojnë njëri-tjetrin në të njëjtën kohë dhe të kenë mundësi të shprehin votën e tyre për vendimet e marra. Të gjithë ata që do të marrin pjesë sipas mënyrës së mësipërme do të konsiderohen si të pranishëm në këtë mbledhje të asamblesë. Në rast se mbledhja zhvillohet në prezencën e një noteri ky i fundit mban shënim mënyrën e votimit të Ortakëve dhe kjo është e mjaftueshme për vlefshmërinë e vendimit, i cili nënshkruhet nga kryetari i mbledhjes dhe nga noteri. Procesverbali i Bordit mund të dërgohet gjithashtu me shkrim me postë ose postë elektronike dhe të nënshkruhet nga Ortaku(ët) që kanë marrë pjesë.
- 15.2 Procesverbali do të mbahet nga një noter publik në rast se kërkohet nga ligji në fuqi dhe/ose kur ndonjë nga Ortakët e gjykon të arsyeshme. Në këtë rast, nuk është i nevojshëm shërbimi i sekretarit.
- 15.3 Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari i mbledhjes dhe sekretari (ose një noter publik). Në rast se është e pamundur që ekstrakti i procesverbalit që përmban vendimet e miratuara, të hartohet dhe të nënshkruhet menjëherë pas përfundimit të mbledhjes, kjo rrethanë do të pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes dhe kryetari është përgjegjës për hartimin e tij dhe qarkullimin e tij tek Ortakët e pranishëm në mbledhje, me e-mail, brenda 3 (tre) ditëve pune nga data e mbledhjes. Të gjithë Ortakët e pranishëm në mbledhje mund të nënshkruajnë kopje të veçanta por të njëjta të procesverbalit dhe vendimeve, kopja origjinale e nënshkruar e secilit duhet t'i dërgohet Administratorit të Shoqërisë jo më vonë se 7 (shtatë) Ditë Pune pas marrjes së draftit. Nëse Administratori nuk ka mbledhur nënshkrimet e të gjithë Ortakëve të pranishëm në mbledhje brenda afatit kohor të përcaktuar më sipër, Administratori është i autorizuar të depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit ekstraktin e procesverbalit që përmban vendimet e miratuara dhe të nënshkruara rregullisht nga kryetari dhe sekretari që përcaktojnë formimin kuorumin, shumicën e kërkuar për vlefshmërinë e vendimeve dhe votimin e secilit Ortak.



D. K

- 15.4 Pa rënë ndesh me atë që është përcaktuar më sipër në nenin 15.3, ekstraktet e vendimeve e miratuara nga asambleja e përgjithshme mund të veçohen nga procesverbali për qëllim të depozitimit të tyre në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe të nënshkruhen rregullisht nga të gjithë Ortakët e pranishëm. Vota kundërshtuese dhe nënshkrimi i Ortakut(ëve) kundërshtues mund të reflektohet në brendësi të vendimeve të miratuara në mbledhje, megjithatë në rast se Ortaku refuzon të nënshkruajë, ky refuzim do të shënohet në mënyrën e duhur nga kryetari i mbledhjes në krah të emrit të ortakut.
- 15.5 Ortakët të cilët refuzojnë të kryejnë veprimet procedurale të përcaktuara në këtë Statut, pa ndikuar në të drejtën e tyre për të votuar kundër vendimeve të propozuara, janë përgjegjës ndaj Ortakut(ëve) tjetër dhe/ose Shoqërisë nëse është rasti dhe detyrohet të shpërblejnë dëmin e shkaktuar nga sjellja e tyre e cila do të konsiderohet në keqbesim. Për të shmangur çdo dyshim Ortaku konsiderohet në shkelje të Statutit nëse refuzon nënshkrimin formalisht të vendimit, për aq kohë sa në vendim është përcaktuar në mënyrë të saktë votimi kundër i Ortakut.

Neni 16

Përfashtimi nga e Drejta e Votës

- 16.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e përgjithshme vendos për
- vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - ngritjen e një padi ndaj tij nga Shoqëria;
 - dhënien e përfitimeve të tjera;

si dhe çdo rast tjetër të parashikuar në Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

- 16.2 Kur Ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe anëtarët që ai përfaqëson.

Neni 17

Largimi dhe Përfashtimi i Ortakut

- 17.1 Largimi i Ortakut rregullohet nga neni 101 i Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
- 17.2 Ortaku që kërkon të largohet nga Shoqëria duhet të njoftojë me shkrim Administratorin në lidhje me qëllimin për t'u larguar si anëtar i Shoqërisë dhe arsyet për këtë largim.
- 17.3 Administratori duhet që menjëherë pas marrjes së njoftimit referuar paragrafit 2 të këtij neni të thërrasë asamblenë e përgjithshme në mënyrë që të vendoset nëse Ortaku do të marrë pagesën në lidhje me kuotat e tij si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.
- 17.4 Asambleja e përgjithshme do të diskutojë arsyet e largimit të paraqitura nga Ortaku që kërkon të largohet dhe do të vendosë nëse shkaqet e largimit janë të arsyeshme dhe mbi shumën dhe mënyrën e pagesës të kuotave të Ortakut që kërkon të largohet. Ortaku që do të largohet mund të fillojë procedurat pranë gjykatës kompetente për t'i kërkuar Shoqërisë likuidimin e kuotës në rast se Administratori nuk



tërret asamblenë e përgjithshme apo nëse kjo e fundit nuk i njeh arsyet e Ortakut për largimin dhe të drejtën e pagesës.

- 17.5 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mbledhet në mënyrë vullnetare apo për mungesë kuorumi ose nëse nuk i pranon shkaqet e largimit si të arsyeshme, pra duke mohuar të drejtën e Ortakut që largohet për t'u paguar brenda një afati prej 30 ditësh nga dita që Administratori ka marrë njoftim për qëllimin për t'u larguar, Ortaku që kërkon të largohet mund:
- a. Të ushtrojë të drejtën e largimit duke njoftuar Administratorin e Shoqërisë në selinë e Shoqërisë, me njoftim me shkrim, brenda një afati prej 30 ditësh nga përfundimi i afatit të parashikuar në Nenin 17.5 më sipër. Në këtë rast largimi do të konsiderohet efektiv që nga data e marrjes së këtij njoftimi me shkrim, pavarësisht faktit nëse kuota është likuiduar apo jo, dhe Administratori do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të regjistruar këtë largim në Qendrën Kombëtare të Biznesit në përputhje me ligjin;
- dhe/ose
- b. Të fillojë procedurat pranë gjykatës kompetente në përputhje me Nenin 17.4, rast në të cilin largimi do të konsiderohet efektiv që prej datës së vendimit përfundimtar të gjykatës në lidhje me këtë çështje.
- 17.6 Ortaku mund të përjashtohet nga Shoqëria vetëm për shkaqe të arsyeshme në përputhje me Nenin 102 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Neni 18

Administrimi dhe Përfaqësimi

- 18.1 Shoqëria do të administrohet në aktivitetin e saj të përditshëm nga një ose më shumë Administratorë të emëruar dhe zëvendësuar nga asambleja e përgjithshme. Për aq kohë sa Shoqëria përbëhet nga dy Ortakë me pjesëmarrje të barabartë, secili nga Ortakët ka të drejtë të emërojë dhe revokojë një Administrator, duke përfshirë vetë Ortakët, që ai e gjykon të përshtatshëm i cili duhet të miratohet nga asambleja e përgjithshme. Në rast se njëri Ortak nuk miraton vendimin e Ortakut tjetër për emërimin ose revokimin e Administratorit të propozuar prej këtij të fundit, ai është përgjegjës kundrejt këtij Ortaku dhe/ose Shoqërisë për dëmet e shkaktuara si pasojë e këtij mosveprimi.
- 18.2 Administratori(ët) mund të emërohen për një mandat deri në 5 (pesë) vjet me të drejtë rinovimi, por në rast se ka më shumë se një Administrator afatet e tyre duhet të jenë të njëjta. Për të shmangur çdo dyshim në rast se një Administrator ekzistues revokohet me propozim të Ortakut që e ka emëruar atë, afati i Administratorit të ri nuk mund të kalojë afatin e Administratorit në detyrë i propozuar nga Ortaku tjetër.
- 18.3 Administratori nuk duhet detyrimisht të jetë Ortak. Të dhënat individuale të Administratorëve përcaktohen në Aneksin A.



18.4 Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Statut, Administratorët kanë kompetenca të plota të cilat ushtrohen bashkërisht për administrimin e zakonshëm dhe të përditshëm të Shoqërisë të listuara në mënyrë jo shteruese si më poshtë:

- administrimi i aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë në përputhje me vendimet dhe udhëzimet e asamblesë së përgjithshme, të marra kohe pas kohe;
- hapja, mbyllja dhe operimi i llogarive bankare të Shoqërisë;
- miratimi për lidhjen e marrëveshjeve ose kryerjen e transaksioneve me palët e treta;
- aplikimi, përgatitja e ofertave dhe/ose dokumenteve, dorëzimi i tyre, ankimi dhe ndjekja e procedurave të prokurimit;
- mbajtja e librave kontabël në përputhje me ligjin dhe parimet e kontabilitetit;
- përgatitja e pasqyrave vjetore financiare të Shoqërisë dhe kontrollin e tyre nga auditorë të jashtëm, nëse ka, për miratim nga asambleja e përgjithshme;
- koordinimi dhe menaxhimi i departamenteve me qëllim të një funksionimi optimal të Shoqërisë;
- administrimi i biznesit dhe departamenteve, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet delegimit dhe/ose ndarjes së kompetencave midis punëmarrësve;
- punësimi dhe zgjidhja e marrëdhënieve të punës të punëmarrësve të Shoqërisë;
- caktimi i kompetencave dhe detyrave të punëmarrësve të Shoqërisë;
- vendosja për shkeljet e disiplinës së punës, shkeljet e detyrave në punë dhe përgjegjësinë e punëmarrësve për kryerjen e detyrave të caktuara në përputhje me ligjin dhe rregulloret e tjera; dhe
- kryerjen e ndonjë aktiviteti tjetër të përcaktuar nga ligji, ky Statut dhe rregullore të tjera, nëse ka.

Miratimi i secilit Administrator mund të jepet me shkrim, por mund të jepet edhe nëpërmjet e-mail-it, nënshkrimit të përbashkët të dokumentit/aktit, kryerjes së përbashkët të veprimeve nëse është e mundur për aq sa e lejon teknologjia (e-banking ose procedura të ngjashme) ose me vendim të përbashkët të tyre.

18.5 Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Statut, Administratorët janë të autorizuar të përfaqësojnë Shoqërinë bashkërisht për të gjitha veprimet me palët e treta, private dhe publike. Miratimi i secilit Administrator duhet të jepet me shkrim, por mund të jepet nëpërmjet e-mail-it, nënshkrimit të përbashkët të dokumentit/aktit, kryerjes së përbashkët të veprimeve nëse është e mundur për aq sa e lejon teknologjia (e-banking ose procedura të ngjashme) ose me vendim të përbashkët të tyre.

18.6 Gjatë kryerjes së detyrës, Administratori(ët) duhet të tregojë kujdesin e duhur të një personi të besueshëm dhe të ndërgjegjshëm të biznesit dhe të respektojë fshehtësinë e çështjeve konfidenciale.

18.7 Administratorët mund të autorizojnë me prokurë persona të tretë ose Administratorin tjetër për të kryer veprime dhe/ose për të ushtruar tërësisht ose pjesërisht në emër dhe për llogari të tyre tagrat e administratorit të përcaktuara sipas këtij Statuti ose vendimeve të asamblesë së përgjithshme. Për të shmangur çdo dyshim, autorizimi nga secili Administrator mund të lëshohet edhe në favor të të njëjtit person, ose të një Administratori. Për aq kohë sa Administratorët janë edhe Ortakë të Shoqërisë, miratimi i prokurës që transferon tagra të përgjithshme të administrimit dhe përfaqësimit nuk ka nevojë të miratohet nga asambleja e përgjithshme.



- 18.8 Për të shmangur çdo dyshim, kompetencat dhe modalitetet e përfaqësimit të Administratorëve dhe Aneksi A mund të ndryshohet me vendim të asamblesë së përgjithshme me Shumicë të Thjeshtë, pa pasur nevojë për vendim mbi ndryshimin e Statutit të Shoqërisë.

Neni 19

Detyrimet e Besnikërisë dhe Përgjegjësia

- 19.1 Përveç detyrimeve të përgjithshme të parimit të besnikërisë të parashikuara në Nenet 14, 15, 17 dhe 18 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, Administratori duhet:
- të kryejë detyrat e tij në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare apo këtë Statut në mirëbesim dhe duke marrë parasysh interesat e Shoqërisë në përgjithësi, dhe në veçanti duke konsideruar ndikimin në mjedis të veprimtarisë së saj;
 - të ushtrojë detyrat e tij që i janë dhënë në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare apo këtë Statut, vetëm për qëllimet e përcaktuara në këtë Statut;
 - të konsiderojë në mënyrë të përshtatshme çështjet për të cilat duhet të vendoset;
 - të parandalojë dhe të shmangë konfliktet ekzistuese dhe të mundshme ndërmjet interesave personale dhe atyre të Shoqërisë;
 - të ushtrojë detyrat e tij sipas parimit të kujdesit dhe të profesionalizmit;
 - të ofrojë çdo informacion në lidhje me biznesin dhe të dhënat ekonomike të Shoqërisë të kërkuar nga secili prej Ortakëve, brenda një fati kohor të përshtatshëm dhe në çdo rast jo më vonë se 7 ditë. Informacioni dhe të dhënat duhen përditësuar.
- 19.2 Administratori gjatë ushtrimit të detyrave të tij, do të jetë përgjegjës ndaj Shoqërisë për çdo veprim apo mosveprim që lidhet në mënyrë të arsyeshme me objektin e Shoqërisë, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi apo mosveprimi është ushtruar në mirëbesim.
- 19.3 Në rast të shkeljes së detyrave dhe standardit të kujdesit të duhur të referuar në paragrafët 1 dhe 2 të këtij Neni, Administratori ka detyrimin të dëmshpërblejë Shoqërinë për çdo dëm që rezulton nga kjo shkelje. Ai/ajo gjithashtu duhet të dorëzojë çdo fitim personal të përfituar nga ai apo Persona të Lidhur gjatë shkeljes së detyrimeve të tij. Ai/ajo do të ketë barrën e provës për të provuar përputhshmërinë e ushtrimit të detyrave të tij me standardet e kërkuara.
- 19.4 Veçanërisht, por jo vetëm, Administratori është i detyruar të dëmshpërblejë Shoqërinë në lidhje me dëmin e shkaktuar, nëse, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare, kryen veprimet e mëposhtme:
- u kthejnë ortakëve kontributet;
 - u paguajnë ortakëve interesa apo dividendë;
 - shpërndajnë aktivet e Shoqërisë;
 - lejojnë që Shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
 - japin kredi.



Dok

- 19.5 Neni 92, paragrafi 6 i Ligjit për Shoqëritë Tregtare zbatohet edhe për paditë, që rrjedhin nga paragrafët e këtij Neni. Këto padi duhet të ngrihen brenda 3 vjetëve nga kryerja e shkeljes apo nga zbulimi i saj.

IV. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 20

Ndalimi i konkurrencës

- 20.1 Çdo Ortak, në përputhje me nenin 17 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, merr përsipër ndaj Ortakut tjetër dhe Shoqërisë që nuk do të kryejë, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Ortakut tjetër, qoftë vetëm ose bashkërisht, aktivitet konkurrent prodhimi, si dhe nuk do të vazhdojë ose nuk do të angazhohet, lidhet ose të interesohet ose të ndihmojë një biznes që konkurren me Shoqërinë në lidhje me aktivitetin e prodhimit. Aktiviteti i menaxhimit të faqes web të shitjeve që Shoqëria mund të menaxhojë vetë ose nëpërmjet palëve të treta sipas marrëveshjeve të lidhura me këto të fundit, ose aktivitete të shitjes ose shpërndarjes të kryera nëpërmjet këtyre faqeve nuk do të konsiderohen si aktivitet konkurrent.
- 20.2 Kufizimet e përfshira në pikën 20.1 do të zbatohen për aq kohë sa Ortaku është një ortak në Shoqëri dhe brenda një periudhe prej një viti nga data në të cilën ai Ortak pushon së qeni Ortak i Shoqërisë.
- 20.3 Çdo angazhim në këtë nen përbën një angazhim krejtësisht të veçantë. Ortakët konsiderojnë se kufizimet e përfshira në këtë nen janë të arsyeshme, por nëse ndonjë kufizim i tillë do të gjykohej i pavlefshëm ose joefektiv, por do të ishte i vlefshëm dhe efektiv nëse ndonjë pjesë e tij do të fshihej ose periudha ose zona e aplikimit do të zvogëlonte këto kufizime, ato do të zbatohen me modifikime të tilla që mund të jenë të nevojshme për ta bërë atë të vlefshme dhe efektive.

Neni 21

Eksperti(ët) Kontabël i Autorizuar

Eksperti(ët) Kontabël do të emërohet me vendim të asamblesë së përgjithshme, nëse është e nevojshme ose bëhet e detyrueshme në përputhje me ligjin.

Neni 22

Dividendët dhe Fitimi

Ortakët kanë të drejtë për një pjesë të fitimit të paraqitur në pasqyrat financiare të Shoqërisë që do të shpërndahet në përputhje me parashikimet e këtij Statuti dhe në përputhje me parashikimet e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Neni 23

Viti Financiar

Viti financiar i aktivitetit të Shoqërisë përkon me vitin kalendarik, fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti..



Neni 24
Bilanci. Mbajtja e Llogarisë

- 24.1 Bilanci i Shoqërisë miratohet nga asambleja e përgjithshme dhe duhet të përgatitet për t'ju paraqitur organeve tatimore përpara përfundimit të muajit mars të vitit pasues.
- 24.2 Librat e llogarisë duhet të mbahen në gjuhën shqipe dhe në monedhën vendase (Lek). Shoqëria mund të mbajë llogari të veçanta në monedhë të huaj, shuma e të cilave duhet të konvertohet, çdo muaj, në monedhën vendase.
- 24.3 Shoqëria mund të marrë financime nga institucione financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë saj. Për këtë arsye Ortakët dhe/ose Shoqëria mund të vendosin barrë siguroese, ose hipotekë mbi pasuritë e paluajtshme, me vendim të asamblesë së përgjithshme në përputhje me parashikimet e këtij Statuti.

Neni 25
Likuidimi

- 25.1 Asambleja e përgjithshme mund të vendosë të likujdojë Shoqërinë.
- 25.2 Me vendim të asamblesë së përgjithshme do të caktohet një likuidator ose një grup likuidatorësh që do të merren me procedurat e likuidimit.
- 25.3 Likuidatori(ët) do të përgatisin raportin e likuidimit, i cili përmban një përmbledhje të gjendjes ekonomike të Shoqërisë, hapat e likuidimit dhe kohën e nevojshme për përfundimin e tij. Në fund të këtij procesi, asambleja e përgjithshme do të miratojë bilancin përfundimtar dhe do të japë miratimin për përfundimin e procedurës së likuidimit.

Neni 26
Ndryshimi i Statutit

Dispozitat e këtij Statuti mund të ndryshohen nga asambleja e përgjithshme, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe të këtij Statuti. Ndryshimi, me vendim të asamblesë së përgjithshme, i të dhënave, përmbajtjes ose dispozitave në nenet 6.1, 7.1, 8, 14.4.2, 18.4, 18.5, ose në Aneksin A nuk do të konsiderohet si ndryshim i këtij Statuti.

Neni 27
Dispozita Përfundimtare

Ky Statut hartohet dhe nënshkruhet në (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Nënshkruar më 21.01.2022

ORTAKËT



Do k

Adelina Krasniqi

Drialb Koxhaj

Adelina Krasniqi

Drialb Koxhaj



A

Dok

ANEKS A
Administratorët e Shoqërisë

1. **Znj. Adelina Krasniqi**, shtetase britanike, lindur më 10.06.1983, në Prizren, mbajtëse e pasaportës me nr. 523757002, caktuar për një afat prej 5 (pesë) vjet;
2. **Z. Drialb Koxhaj**, shtetas shqiptar, lindur më 19.05.1999, në Berat, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal: J90519052S, caktuar për një afat prej 5 vjet.



DoK

DEKLARATË

Sot më 21/01/2022, unë, Znj. **Adelina Krasniqi**, lindur më 10.06.1983 pranoj emërimin tim dhe të drejtat dhe përgjegjësitë si administrator i shoqërisë që do të themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “**Tailor’s Vision**” SHPK.

Specimeni i nënshkrimit tim ndodhet më poshtë:



Znj. **Adelina Krasniqi**

Adelina Krasniqi



DEKLARATË

Sot më 21.01.2022, unë, Z. **Drialb Koxhaj** lindur më 19.05.1999 pranoj emërimin tim dhe të drejtat dhe përgjegjësitë si administrator i shoqërisë që do të themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "**Tailor's Vision**" SHPK.

Specimeni i nënshkrimit tim ndodhet më poshtë:

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'Drialb Koxhaj', written over a horizontal line.

Z. **Drialb Koxhaj**

Drialb Koxhaj
